


Udhëzues për Shtatzëninë e Paplanifikuar

Një shtatzëni e paplanifikuar mund të jetë një sfida serioze emocionale dhe praktike për të gjithë të përfshirët dhe mund të ngrejë shumë pyetje, ndjesi kontradiktore dhe frikë. Ky udhëzues është hartuar për gratë shtatzënë dhe rrethin e tyre familjar dhe shoqëror. Ai ofron një pasqyrë të përgjithshme të kuadrit ligjor, udhëzime mbi opsionet e mundshme dhe jep detaje mbi asistencën dhe këshillimin. Synon t'ju mbështesë në marrjen e një vendimi që i përshtatet rrethanave tuaja personale. Ju keni të drejtë të merrni këshillim dhe asistencë falas.



*Vendimi është
në dorën tuaj, nuk ka një
zgjedhje të vetme të
drejtë ose të gabuar!*



Amësia/Prindërimi

Nëse vendosni ta vazhdoni shtatzëninë deri në lindje dhe të kujdeseni vetë për fëmijën, qoftë vetëm, së bashku me prindin / babain e fëmijës, ose me mbështetjen e personave të tjerë, mund të lindin sfida dhe pyetje të ndryshme. Në këto raste, ju ofrohet një gamë shërbimesh asistence dhe këshillimi, për shembull në lidhje me çështjet financiare, çështjet e punësimit ose të së drejtës civile, vështirësitë brenda marrëdhënies ose pyetjet në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve në të ardhmen.

Aborti



Në parim, vendimi përfundimtar nëse do të vazhdoni apo do të ndërpritni shtatzëninë i takon gruas shtatzënë.

Nëse dëshironi të ndërpritni shtatzëninë, ju lutemi konsultohuni me një gjinekolog. Ata do të zhvillojnë një bisedë të detajuar me ju. Këshillimi përkatës mund t'ju ndihmojë të merrni vendimin e duhur. Do të merrni informacion lidhur me asistencën e mëtejshme. Gjatë konsultës fillestare, shpjegohen rregulloret ligjore, rreziqet shëndetësore dhe procesi i ndërprerjes së shtatzënisë. Nëse nuk jeni e sigurt, kërkoni këshillim falas, konfidencial dhe të paanshëm.

Në Zvicër, ndërprerja e shtatzënisë lejohet me kërkesë të gruas shtatzënë deri në javën e dymbëdhjetë të shtatzënisë. Për një ndërprerje të mëvonshme, duhet të ketë arsye mjekësore që përfshijnë një rrezik serioz për gruan shtatzënë. Shpenzimet e ndërprerjes së shtatzënisë mbulohen nga sigurimi shëndetësor bazë.

Ekzistojnë dy metoda për ndërprerjen e shtatzënisë:

- Aborti me medikamente: kryhet duke marrë një bar të miratuar.
- Aborti kirurgjikal: kryhet nëpërmjet një procedure mjekësore

Zgjedhja e metodës suaj së përshtatshme, ndër të tjera, varet nga faza e shtatzënisë dhe shëndeti juaj. Gjatë konsultës me mjekun tuaj, do të përcaktoni së bashku se cilat mundësi keni në dispozicion.

Jeni nën moshën 16 vjeç?

Jeni nën 16 vjeç dhe dëshironi të ndërprisni shtatzëninë? Në këtë rast, ligji kërkon që, përveç një konsultimi të detajuar me gjinekologun tuaj, të kontaktoni edhe Qendrën e konsultave për gratë shtatzëna (elbe). Këshillimi është falas dhe mbetet konfidencial. Ju keni të drejtë të vendosni vetë nëse doni ta vazhdoni shtatzëninë apo jo, edhe pa dijeninë e prindërve/kujdestarëve tuaj ligjorë.



Dhënia e pëlqimit për birësim

Nëse nuk dëshironi/nuk mund ta ndërprisni shtatzëninë, ose nëse nuk mund të kryeni abort për shkak të fazës së avancuar të shtatzënisë, mund ta jepni fëmijën për birësim pas lindjes. Është e rëndësishme që të kërkonit këshillim dhe ndihmë. Këshillimi është falas dhe mbetet konfidencial.

Informacioni dhe këshillimi mund të merret nga qendra e konsultave për gratë shtatzëna (elbe), organizata “Sexuelle Gesundheit Schweiz”, qendra e këshillimit për birësim ose klinika për shëndetin e gruas në rajonin tuaj.

Lindja duke ruajtur anonimitetin

Nëse nuk keni dëshirë që askush në familjen ose rrethin tuaj shoqëror të jetë në dijeni për shtatzëninë tuaj, mund të lindni duke ruajtur anonimitetin tuaj. Kjo nënkupton që do të merrni kujdes dhe ndihmë mjekësore nën një pseudonim gjatë shtatzënisë dhe lindjes. Të dhënat tuaja personale do të mbahen konfidenciale dhe do të ndahen vetëm me zyrën e gjendjes civile dhe autoritetin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve. Pas lindjes, mund ta jepni fëmijën për birësim, me kusht që babai/prindi tjetër të jetë dakord ose identiteti i prindit tjetër është i panjohur.

Informacioni dhe këshillimi mbi lindjen duke ruajtur anonimitetin janë të disponueshme nga qendra e konsultave për gratë shtatzëna (elbe), qendra e këshillimit për birësim ose klinika për shëndetin e gruas në rajonin tuaj.

Informacione shtesë dhe adresat e pikave të kontaktit për kantonin ku banoni mund t'i gjeni gjithashtu në faqen e internetit të “Sexuelle Gesundheit Schweiz” në <https://sexuelle-gesundheit.ch>.

Qendrat e konsultave



Në zbatim të Ligjit Federal për qendrat e konsultave për gratë shtatzëna, ju keni të drejtë për konsultë dhe mbështetje të menjëhershme, falas, të hapur dhe konfidenciale, pavarësisht vendimit tuaj. Konsultat zhvillohen për çështje sociale, psikologjike, financiare dhe ligjore, ku ju ofrohet informacion nga ekspertët ose ndihmë për të marrë një vendim. Ju mund të kontaktoni qendrën e konsultave vetëm, si çift ose me një person tjetër mbështetës.

Qendra e konsultave për gratë shtatzëna në kantonin Luzern

elbe – Fachstelle für Lebensfragen,
Schwangerschaft & Familienplanung
Hertensteinstrasse 28
6004 Luzern

☎ +41 41 210 10 87

✉ info@elbeluzern.ch

🌐 <https://elbeluzern.ch>

Qendra e këshillimit për birësim

PACH – Pflege- und Adoptivkinder
Schweiz
Pfingstweidstrasse 16
8005 Zürich

☎ +41 44 205 50 40

✉ info@pa-ch.ch

🌐 <https://pa-ch.ch>

Qendra e konsultave mjekësore

🌐 <https://luks.ch>

Vendndodhja Luzern
Luzerner Kantonsspital
Frauenklinik
Haus 21
Spitalstrasse
6000 Luzern 16

☎ +41 41 205 35 10

✉ frauenklinik.luzern@luks.ch

Vendndodhja Sursee
Luzerner Kantonsspital
Frauenklinik
Spitalstrasse 16a
6210 Sursee

☎ +41 41 926 42 00

✉ frauenklinik.sursee@luks.ch

Vendndodhja Wolhusen
Luzerner Kantonsspital
Gynäkologie und Geburtshilfe
Spitalstrasse 50
6110 Wolhusen

☎ +41 41 492 84 05

✉ anmeldung-wolhusen.frauenklinik@luks.ch

Gjinekologu juaj / Gjinekologia juaj

Qendrat e këshillimit social

 <https://sobz.ch>

SoBZ Region Willisau-Wiggertal
Kreuzstrasse 3B, Postfach
6130 Willisau

 +41 41 972 56 20

 info@sobz-willisau.ch

 <https://sobz-willisau-wiggertal.ch>

SoBZ Region Entlebuch, Wolhusen
und Ruswil
Hauptstrasse 13
6170 Schüpfheim

 +41 41 485 72 00

 info@sobz-entlebuch.ch

 <https://sobz-entlebuch.ch>

Zentrum für Soziales – Vendndodhja
Hochdorf
Bankstrasse 3b, Postfach
6281 Hochdorf

 +41 41 914 31 31

 hochdorf@zenso.ch

 <https://zenso.ch>

Zentrum für Soziales – Vendndodhja
Sursee
Christoph-Schnyder-Strasse 4b
6210 Sursee

 +41 41 925 18 25

 sursee@zenso.ch

 <https://zenso.ch>

Stadt Luzern – Kinder Jugend Familie
Kasernenplatz 3
6000 Luzern

 +41 41 208 72 90

 info@contactluzern.ch

 <https://contactluzern.ch>

Stadt Luzern – Sozialzentrum Rex
Obergrundstrasse 3
6002 Luzern

 +41 41 208 72 22

 <https://stadtluzern.ch>

Linja të përgjithshme për raste krize dhe emergjence

Luzerner Psychiatrie – Zentrale Anmelde- und
Koordinationsstelle (ZAK)
Schafmattstrasse 1
4915 St. Urban

 +41 58 856 53 00

 anmeldung@lups.ch

 <https://lups.ch/zuweisung-alt/zak>

147 – Pro Juventute (për fëmijët / të rinjtë)

 147

 0800 147 000

 <https://147.ch>

143 – Dargebotene Hand (për të rritur)

 143

 <https://143.ch>